



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 27, datë 11.06.2025

**PËR NDRYSHIMIN E PIKËS 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 166,
DATË 03.11.2023 “PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT ARTISTIK
PRANË QENDRËS KULTURORE “ALEKSANDËR MOISIU”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr. 115, datë 24.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025 dhe programin buxhetor afatmesëm 2025-2027” dhe sipas relacionit të Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**



1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1, të VKB-së Nr. 166, datë 03.11.2023 përsa i përket përbërjes së Bordit Artistik pranë Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu” Durrës me zëvendësimin si më poshtë :

Z. Elio Bajramaj zëvendësohet me znj. Alketa Tragaj me detyrë Drejtor i Q.K. “A. Moisiu”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Qendra Kulturore “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi




U shpall sot me datë 12.06.2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 399₇ prot.

Durrës, më 16 . 06 .2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.27 datë 11.06.2025 ,” Për ndryshimin e pikës 1, të vendimit të këshillit bashkiak nr.166 datë 03.11.2023 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit artistik pranë qendrës kulturore “Aleksandër Moisiu”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

